



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 661, datë 02.11.2023**

**PËR**

**PËRLLOGARITJEN E PAGËS REFERUESE BAZË TË MAGJISTRATIT (GJYQITAR),  
PËR PERIUdhËN 1 JANAR 2019 DERI MË  
08 JANAR 2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 4, 18, 147 dhe 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 "Për Buxhetin e vitit 2023", nenit 12 pika 5 shkronja “a” të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas gjendjes së dispozitës para ndryshimeve me ligjin nr.50/2021, vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

**VENDOSI:**

1. “Paga referuese bazë” e magjistratit (gjyqtar), është e barabartë me shumën e shtesës për pozicion të nëpunësit të shërbimit civil Klasa e parë (I), Kategoria e dytë (I-b), niveli I-b, plus pagën e grupit, për periudhën nga data 1 janar 2019 deri më 8 janar 2023.
2. Përllogaritjen e “Pagës referuese bazë” të magjistratit (gjyqtar), sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij vendimi, duke përfshirë edhe efektet financiare që ka prodhuar vendimi nr. 351, datë 27.07.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Ngarkohet Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, me ndjekjen e procedurave ligjore e nënligjore për menaxhimin e sistemit buxhetor, duke marrë masat e duhura për përllogaritjen dhe sigurimin e fondeve buxhetore të nevojshme për pagën referuese bazë, nga fondet e buxhetit të vitit në vazhdim dhe duke kërkuar fonde shtesë për vitin 2024 për gjithë sistemin gjyqësor.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**